



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 163/3 prot.

Tiranë, më 21. 04. 2022

V E N D I M

Nr. 78, datë 21. 04. 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ shqyrtoi ankesën nr.15, datë 24.01.2022, të z. J. B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar², nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, referuar pretendimeve të depozituara në formularin e ankesës, ka parashtruar ndër të tjera se, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore të tij, është paraqitur shpesh në Urgjencën e Spitalit Rajonal Shkodër. Sipas ankuesit, stafi i urgjencës nuk i ofron shërbimin në mënyrën e duhur, madje në disa raste pretendon se është bullizuar dhe ofenduar për shkak të gjendjes shëndetësore, duke mos i dhënë shërbimin shëndetësor të kërkuar.

Në vijim ankuesi pretendon se: “Më datë 02.01.2022, jam paraqitur në Urgjencë dhe më është hapur Kartela Mjekësore, në të cilën stafi ka rekomanduar vizitë tek psikiatri, por nuk ka ardhur asnjë mjek të më ekzaminojë, qoftë edhe psikiatri, siç është cituar në kartelën mjekësore. Unë kam bërë disa kërkesa drejtuar Spitalit Rajonal Shkodër, pasi këto sjellje ndaj meje janë të përsëritura dhe diskriminuese...”.

Në këtë kuptim, ai kërkon nga Komisioneri, të ndalohet situata diskriminuese e pretenduar dhe të marrë shërbimin e duhur nga ana e strukturave të Spitalit Rajonal Shkodër, si çdo qytetarë tjetër pa diskriminim.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD..

² Referuar Vendimit Nr. 4286, datë 26.01.2021 të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar³, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon në mënyrë të drejtëpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, të pretenduar nga ankuesi si shkak diskriminues, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

LMD, në nenin 3, pika 1, të tij, parashikon : “1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”

Bazuar në nenin 5, të LMD-së, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr.163/1 prot., datë 11.02.2022 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁴ Spitalit Rajonal Shkodër, lidhur me pretendimet e ankuesit.

Në përgjigje përsa më sipër, Spitali Rajonal Shkodër, me anë të shkresës⁵ nr. 377/1 prot., datë 21.02.2022, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Në të gjitha rastet nga na e Spitalit Rajonal Shkodër nuk ka munguar shërbimi i kërkuar pavarësisht faktit që diagnozat nga të cilat personi vuan, janë shprehje që kërkojnë përkujdesje të vazhdueshme nga disiplinat e kujdesit të shëndetit mendor të cilat janë në varësi të strukturave mjekësore të Njësisë së Kujdesit Shëndetësor Vendor Shkodër (NJVKSH)...”.

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Spitali Rajonal Shkodër, vuri në dispozicion të KMD-së, kopje të:

- Kartelave Mjekësore dhe Rekomandimeve për rastet që ankuesi është paraqitur pranë Shërbimit të Urgjencës;
- Shkresës kthim përgjigje të Shefit të Shërbimit të Urgjencës Dr. E. T., mbi ankesën e J. B.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

⁴ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Kopje të ankesave për diskriminim të ankuesit dhe përgjigjeve të Spitalit Rajonal Shkodër.
- Informacion në lidhje me rastet që ankuesi, është paraqitur për të marrë trajtim shëndetësor pranë Spitalit Rajonal Shkodër, përgjatë vitit 2022? Cilat kanë qenë problematikat për të cilat është trajtuar dhe çfarë procedurash janë ndjekur për trajtimin e tij? Informacioni të shoqërohet me kopje të akteve përkatëse (kopje të regjistrave, kartelës së trajtimit pacientit, ekzaminimet apo trajtimet e marra nga ky shtetas etj.).

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 163/2 prot., datë 23.02.2022

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfutur të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me shërbimit të kujdesit shëndetësor të kërkuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Ankuesi J. B., është i datëlindjes 06.04.1996 dhe banon në qytetin e Shkodrës. Ai vuan nga probleme shëndetësore të sferës neuro-psikike dhe me vendimin nr. 4286, datë 26.01.2021, të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, Niveli i Parë Neurologji – N/Kirurgji, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara në Rrethin e Tiranës, është vlerësuar person me aftësi të kufizuara i grupit të dytë, me diagnozën “*Epilepsi bilaterale, Dandy Walker*”.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi ka parashtruar pretendimin se është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e stafit të Urgjencës Mjekësore të Spitalit Rajonal Shkodër, të cilët, sipas tij, nuk i ka ofruar shërbim si çdo qytetari tjetër, për shkak se është person me aftësi të kufizuara.

⁶ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “*Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...*”

Nga informacioni i administruar dhe vënë në dispozicion nga ana e ankuesit, rezulton se ai në datat 13.12.2021, 19.12.2021, 21.12.2021, 30.07.2021 dhe 05.01.2022, i është drejtuar Spitalit Rajonal Shkodër me ankesa për diskriminimin e tij nga ana e stafit të Urgjencës Spitalore të këtij institucioni. Në ankesat e parashtruara, ankuesi pretendon se nga ana e tyre është trajtuar në mënyrë fyese nga ana e stafit të Urgjencës Mjekësore për shkak të aftësisë së kufizuar të tij.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e palës ndaj së cilës është drejtuar ankesa, rezulton se Shefi i Shërbimit të Urgjencës Mjekësore të këtij institucioni, me shkresën datë 10.01.2022, i është drejtuar Drejtorisë së Spitalit Rajonal Shkodër, duke i sqaruar dhe dhënë informacion lidhur me ankesat për diskriminim të J. B. Ndër të tjera nga ana e Shefit të Shërbimit të Urgjencës Mjekësore, sqarohet se: *“...personi në fjalë është paraqitur në Urgjencën e Spitalit Rajonal Shkodër, nga ku ka marrë dhe shërbimin përkatës nga stafi mjekësor nga periudha 01.01.2021 deri më datë 10.01.2022, 125 (njëqind e njëzet e pesë) herë (të dokumentuara me kartelat ditore të hapura dhe terapinë e marrë sipas muajve përkatës). Në secilin rast, pacienti ka qenë Kod i Bardhë dhe nuk ka pasur probleme akute, gjithësesi është ndihmuar nga stafi përkatës dhe i është rekomanduar që të vazhdojë ndjekjen me mjekun specialist përkatës për problemin që ka. Pacienti ka paraqitur rezistencë disa herë në marrjen e shërbimit sipas rekomandimit të mjekut të urgjencës dhe është konfliktual me stafin, sepse kërkon të marrë mjekimin sipas mendimit të vet. Mendoj që personi në fjalë ka nevojë të ndiqet nga mjeku specialist për problemin që paraqet dhe ne si shërbim jemi të gatshëm të ofrojmë shërbimin tonë (si ndaj çdo pacienti tjetër) në çdo situatë urgjence të nevojshme.”*

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër, ankuesi i është drejtuar Shërbimit të Urgjencës, gjatë periudhës 02.01.2022 deri më datë 13.02.2022, 23 (njëzet e tre) herë, ku nga Kartelat dhe Rekomandimet e Brendshme, konstatohet që ankuesi ka marrë mjekimet përkatëse dhe i janë kryer ekzaminimet (analiza gjaku etj.) e rekomanduara nga mjekët në 3 (tre) raste gjatë kësaj periudhe.

Gjithashtu, rezulton se në datat në të cilat ankuesi pretendon sjelljen diskriminuese nga ana e stafit mjekësor të Urgjencës, ai ka marrë mjekimin e rekomanduar nga mjekët, por shqetësimin e tij e lidh me faktin e sjelljes jo korrekte nga ana e tyre. Pra, në analizë të informacionit të administruar, nuk rezulton që ankuesi të jetë paraqitur pranë Urgjencës së Spitalit Rajonal Shkodër dhe të mos ketë marrë shërbimin e duhur mjekësor apo ndaj tij të ketë patur një sjellje fyese apo ofenduese.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin nëse ka patur sjellje të cilat e kanë ekspozuar ankuesin ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë. Pretendimet e ankuesit se ndaj tij ka patur një sjellje diskriminuese duke u ofenduar dhe fyer nga ana e stafit mjekësor të Urgjencës së Spitalit Rajonal

Shkodër nuk u arrit të vërtetohet bazuar në provat e administruara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës.

Megjithatë, bazuar në rrethanat e konstatuara si më sipër dhe nisur nga rëndësia e kësaj çështje, Komisioneri vlerëson të evidentojë disa çështje në lidhje me qasjen e treguar nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër:

- evidentohet se J. B. nuk i është kthyer përgjigje lidhur me ankesat për diskriminimin, pavarësisht se ato janë trajtuar nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër. Në këtë kuptim, strukturat e Spitalit Rajonal Shkodër, pavarësisht faktit që i kanë dhënë shërbimin e nevojshëm, referuar nenit 5⁷ të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në çdo rast duhet të marrin në shqyrtim dhe t’i kthejnë përgjigje ankuesit, lidhur me ankesat me objekt diskriminimin;

Personat me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejta të barabarta për akses në kujdesin shëndetësor cilësor njëloj si pjesa tjetër e popullsisë. Neni 25 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁸ përcakton qartë, se: *“Shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për të siguruar mundësimin për personat me aftësi të kufizuara të shërbimet shëndetësore të lidhura me gjininë, përfshirë rehabilitimin lidhur me shëndetin”*.

Komiteti i OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pas raportimit të parë për zbatimin e KDKPAK⁹-ut, vëren se vazhdojnë të mbeten të pamjaftueshme: shërbimet dhe mjediset e kujdesit shëndetësor në komunitet për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata me aftësi të kufizuara intelektuale dhe ata që kërkojnë mbështetje të plotë; programet për identifikimin e hershëm për personat me autizëm dhe për personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në zonat rurale; mundësia e përdorimit nga personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht të moshuarit, romët dhe gratë e vajzat me aftësi të kufizuara, të shërbimeve të kujdesit shëndetësor gjithëpërfshirës dhe shqetësimet për shëndetin seksual e riprodhues dhe për të drejtat, në kushte të barabarta me të tjerët.¹⁰

Rekomandimet e dhëna nga Komiteti theksojnë se shteti shqiptar, duhet: *“Të sigurojë dhe të monitorojë në mënyrë efektive që ofruesit e shërbimeve shëndetësore të ofrojnë shërbime shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim dhe në kushte të barabarta me të tjerët, duke bërë të disponueshme dhe të aksesueshme pajisjet dhe instrumentet e nevojshme dhe teknologjitë ndihmëse, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë, të*

⁷ LMD, në nenin 5 parashikon se: *“Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

⁸ Ligj Nr. 108/2012 Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së *“Për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*

⁹ Shkurtesë e Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

¹⁰ Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, fq. 64

*aksesojnë shërbime, përfshirë shërbimet e shëndetit riprodhues sa më afër shtëpisë, në konsultim të ngushtë me organizatat përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara”.*¹¹

Referuar Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, një ndër qëllimet politike të saj, ka dhe ofrimin e një kujdesi shëndetësor të aksesueshëm e të përballueshëm për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj politike të hartuar në këtë dokument, në fushën e shëndetësisë për të pasur shërbime shëndetësore të aksesueshme, të përballueshme dhe të barabarta është në përputhje të plotë me rekomandimet e përmendura më sipër. Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore në partneritet edhe me institucionet apo/ dhe organizata të shoqërisë civile do të fokusohen në 2 objektiva specifike:

- Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara
Objektivi specifik;
- Zhvillimi i shërbimeve të parandalimit, ndërhyrjes së hershme dhe rehabilitimit për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara.

Në këtë kontekst, Komisioneri rekomandon Spitalin Rajonal Shkodër të ofrojë një trajtim preferencial për personat me aftësi të kufizuara, marrë në konsideratë aftësinë e kufizuar, duke lehtësuar komunikimin me personat me aftësi të kufizuar që paraqiten për të marrë shërbimet shëndetësore të kërkuara.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se nuk u administruan prova me anë të të cilave të konstatohet se Spitali Rajonal Shkodër ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e strukturave të Spitalit Rajonal Shkodër, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

¹¹ Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, fq. 64

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit J. B. për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Spitalit Rajonal Shkodër.
2. Komisioneri rekomandon Spitalin Rajonal Shkodër, që me qëllim garantimin e një aksesit cilësor dhe në baza të barabarta me të tjerët në shërbimet shëndetësore nga ana e personave me aftësi të kufizuara, të marrë masat e mëposhtme:
 - 2.1 Lehtësimin e vizitave mjekësore në institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara, parashikuar edhe në kontekst të Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025;
 - 2.2 Informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit të Spitalit Rajonal Shkodër, për sigurimin e aksesit në kujdesin shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të barabartë me pjesën tjetër të popullsisë;
3. Spitali Rajonal Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)